



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA III

Sesioni IV

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 10.**

Prishtinë, më 20.07.2011 në ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Goran Marinkovic, Myzejene Selmani, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Agim Kuleta, Jasmina Živkovic, Jelena Bontic, Petar Miletic, Mufera Sinik dhe Etem Arifi.

Munguan: Rasim Demiri

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësues të OSB-ja Lejla Selimi, përfaqësuesit nga KDI- Besnik Ramadani, përfaqësuesi nga Presidenca Ukë Gashi dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: Natasa Prica-Tisma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Goran Marinkovic, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Kadastër nr. 04/249/L-013 , me raportin e Komisionit funksionale për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente.
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/ L-08 për Verëra nr. 04/375/L-019 , me raportin e Komisionit funksionale për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente.
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-024 për Ndhmën Shtetërore, me raportin e Komisionit funksionale për Buxhet dhe Financa, me amendamente.
6. Të ndryshme.

Goran Marinkovic-kryetar, u prezantua para anëtarëve të Komisionit se vjen nga grupi i SLS të cilët njëherit e kanë propozuar kryetar të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim. Mendon se do të kemi bashkëpunim të mirë dhe se të gjitha obligimet që dalin nga Komisioni do të realizohen me sukses.

Kryesuesi - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi - konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të kaluar.

Kryesuesi – konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes të datës 12.07.2011, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Kadastër nr. 04/249/L-013 , me raportin e Komisionit funksionale për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin për Kadastër nr. 04/249/L-013, të propozuara nga Komisioni Funkcional. Kërkoj nga anëtarët të deklarojnë nëse ka ndonjë vërejtje në amendamente në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, që do t'i dërgohen Komisionit Funkcional.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryesuesi konstatoi se Komisioni, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Kadastër nr. 04/249/L-013, ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/ L-08 për Verëra nr. 04/375/L-019 , me raportin e Komisionit funksionale për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/ L-08 për Verëra nr. 04/375/L-019, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoj që të njëjtat të përkrahen.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni, njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/ L-08 për Verëra nr. 04/375/L-019, ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II. Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-024 për Ndihmën Shtetërore, me raportin e Komisionit funksionale për Buxhet dhe Financa, me amendamente.

Kryesuesi paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/L-024 për Ndihmën Shtetërore, të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoj që të njëjtat të përkrahen.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryesuesja konstatoi se Komisioni, njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-024 për Ndhmën Shtetërore, ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

6. Të ndryshme

Kryesuesi- njoftoi Komisionin se për takimin e radhës do të njoftohen me kohë.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Goran Marinkovic